



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2021:251571

Datë: 24.11.2023

Numri i dokumentit: 04971423

**C.nr. 2674/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm**– Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen kontestimore të paditësit M.K, nga Peja, të cilin e përfaqëson av. N.I nga Peja, kundër të paditurës T.K, Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, jashtë seance me dt. 24.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HIDHET** padia e paditësit, M.K, nga Peja, kundër të paditurës T.K Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, **si e pa lejuar-e pas afatëshme.**

**A r s y e t i m**

Paditësi pranë kësaj gjykatë me date 09.11.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës për anulimin e vendimit.

Gjykata me datën 20.11.2023, ka caktuar seancën përgatitorë me qëllim të vlerësimit të afatshmërisë së padisë, pasi që nga padia dhe përgjigja në padi, nuk mund të konstatohet data se kur pala paditëse e ka pranuar vendimin i cili është objekt shqyrtimi në këtë çështje. Gjatë seancës pala e paditur ka deklaruar se me parashtrësë të veçantë do ta njoftoj gjykatën lidhur me pranimin e vendimit me nr.01-2033/2021, të dt.06.07.2021, lidhur me revokimin e vendimit me nr.01-2005/2018, të dt. 31.05.2018, nga pala paditëse.

Pala paditëse me parashtrësën e dt. 22.10.2023, e ka njoftuar gjykatën se i padituri M.K e ka pranuar vendimin me dt.12.07.2021, ku parashtrësës i ka bashkangjitur edhe Dokumentin nga Arkivi Qendrorë në Prishtinë, Liber intern i dërgimit.

Gjykata pas vlerësimit të afatshëris së pasisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësit është e pas afatshme pasi që paditësi vendimin nr.01-2033/2021, të dt.06.07.2021, lidhur me revokimin e vendimit nr.01-2005/2018, të dt. 31.05.2018, e ka pranuar me dt. 12.07.2021, ndërsa padinë e ka parashtruar me dt. 09.11.2021, për çka edhe padinë e bënë të pasafatshme.

Sipas dispozitës se nenit 79 të Ligjit të Punës shprehimisht parashihet së: “ Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin e me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk

merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par. 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës e lidhur me nenin 391.1 pika f) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e duke marr për bazë se që paditësi vendimin nr.01-2033/2021, të dt.06.07.2021, lidhur me revokimin e vendimit nr.01-2005/2018, të dt. 31.05.2018, e ka pranuar me dt. 12.07.2021, ndërsa padinë e ka parashtruar me dt. 09.11.2021, vërtetoi se paditësi e ka lëshuar afatin për ushtrimin e padisë, gjegjësisht mbrojtjen e të drejtave të tij pranë gjykatës, edhe pse në vendimin me të cilin është anuluar, i njëjti ishte njoftuar përmes këshillës juridike se në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit mund të inicioj procedurë në Gjykatën Themelore.

Andaj nga të cekurat më lartë e duke u bazuar ne nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës e lidhur me nenin 391.1 pika f) të Ligjit për Procedurën Kontestimore u vendos si në dispozitave të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2021:251571 - C.nr. 2674/21, 24.11.2023**

**Gjyqtari**  
Besnik Shala

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.